

U promovua libri "Lutje në ditën e tetë të javës" i autorit Gjekë Marinaj

Marinaj: Kosova ka qenë, është dhe do të mbetet pjesë e poezisë sime

EPOKA E RE

MINIRE BERISHA


Prishtinë, 26 maj - U promovua libri "Lutje në ditën e tetë të javës" i autorit shqiptar që jeton në Amerikë, Gjekë Marinaj. Libri është botuar nga Shtëpia Botuese "Faik Konica" në Prishtinë.

Ismail Kadare, për autorin Gjekë Marinaj, kishte cituar se dallohej ndër poetët më të mirë shqiptarë të kohës.

Ndërsa poeti Muj Buçpapaj, për librin e Marinajt, ka thënë se poezia e tij i përket shkollës amerikane, madje ka eksperimentuar duke krijuar një kënd të ri për letërsinë, dhe ka një poezi mjaftë të ndërtuar.

Edhe poeti Ramadan Musliu ka thënë se poezia e Gjekë Marinajt është një poezi që të radikalizon.

Publicisti Prend Buzhala ka thënë se lutja ka qenë çelës për çdo rilindje në historinë e krishterimit (Pol Jongi Ço), si një derdhje e re e shpirtit që e udhëheq botën larg shkatërrimit dhe asgjësimit, "Gjuha shpirtërore e lutjes te Marinaj është tjetër, është si ajo Lutja që e zbulon mendjen e Zotit. Sipas Buzhalës, sikundër që librat hyjnorë përmbajnë kapituj e dashurisë, të tillë kapituj kanë edhe librat poetikë të Marinajt "Që na del si dhuntia më e lartë shpirtërore, si përvojë e jetuar dashurie, si dhurim i vetvetes, ashtu sikur ta sugjeron këtë fusha e



Gjekë Marinaj

gjerë kuptimore e referencës ligjërmore poetike", ka thënë ai.

Kurse, shkrimtari Ali Jasiqi, ka thënë se poezia e tij në pjesën me të madhe është reflektive, përkatësisht meditative, për të mos thënë edhe me nuanca të poezisë filozofike. "Autori do të meditoj për shumë probleme jetësore, për qëndrimin e njeriut ndaj dukurive të ndryshme në natyrë dhe përgjithësisht në jetë", është shprehur ai.

Ndërsa autori Gjekë Marinaj, duke i përshëndetur të pranishmit ka thënë se unë gjithmonë jam dhe do të jem produkt i kulturës suaj. "Kosova ka qenë është dhe do të mbetet pjesë e poezisë sime", ka thënë ai.

Në Tetovë u promovua libri për dëshmorin Ismail Mehmeti

Fljimi i një maturanti

EPOKA E RE

ARSIM SINANI

Tetovë, 26 maj - Në ambientet e restorantit "Arra" në Tetovë u bë promovimi i librit "Fljimi i një maturanti" nga autorët Isuf Sherifi dhe Mehmet Selmani.

Kjo monografi i kushtohet dëshmorit të kombit Ismail Mehmeti, i cili ra dëshmor në luftimet e vitit 2001 në Drenovë të Tetovës.

E vogël ishte salla për t'i pritur mysafirët që kishin ardhur nga të gjitha viset shqiptare për ta nderuar figurën e dëshmorit të kombit Ismail Mehmeti. Bashkëlufëtarë, familjarë, miq e shokë kishin ardhur t'i bëjnë nderime familjes Mehmeti nga Drenoci i Tetovës.

Monografia për dëshmorin Ismail Mehmeti është në autorësi të krijuesve Isuf Sherifi dhe profesorit Memet Selmani. Monografia është botuar nga Shtëpia Botuese "Arbëria Design" nga Tetova, ndërsa për të është perkujdesur Shoqata Kulturorë Shqiptare në St Gallen të Zvicrës. Për jetën dhe veprën e Ismail Mehmetit foli krijuesi Isuf Sherifi, i cili elaboroi në mënyrë të thuktë veprimtarinë e familjes Mehmeti dhe në veçanti të dëshmorit maturant Ismail Mehmeti.

"Ismail Mehmeti hyn në radhën e luftëtarëve të lirisë që me gjakun e tyre shkruan faqe të



reja të historisë tonë kombëtare", ka thënë Isuf Sherifi.

Aktivitetin e përshëndeti edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Memli Krasniqi, i cili e vlerësoi veprimtarinë atdhetare të dëshmorit Ismail Mehmeti.

Në emër të shokëve përshëndeti shoku i tij Aliberi, i cili, shumë i emocionuar, ka thënë se kurrë nuk do ta harrojnë Ismailin dhe veprën e tij.

"Çdo ditë e ndiejmë mungesën tënde por fjalët e tua na mbeten ngushëllimi i vetëm për ty", është shprehur ai.

Po ashtu u këndua edhe një këngë për Ismail Mehmetin dhe u recituan poezitë e dëshmorit Ismail Mehmeti.

Në fund autorët Sherifi dhe Selmani i dhuruan nga një libër dhe nga një bluzë me foton e djalit të tyre prindërve të dëshmorit Ismail Mehmeti.

SHKOVA

Shkova për shkak të vetnisë
Shkova për hir të lirisë
Shkova se u deshtë të shkojë
Se në këtë botë s'munda të rroj.

Ju o shokë mos më qani
Por ju lutem të më këndon
S'dua të qitni as një lot
Se unë nuk shkova kot

Dhe ta dini ta dini se kam
shkuar
Duke kënduar me plot mal-
lëngjim dhe gëzim
Që ky vend të jetë në liri

Unë shkova por ju mos shkoni
Që lirinë mandej ta gëzoni
Nga gjaku im i kuq
Dhe trimat që janë me mua
Prandaj ju lus
Dhe me mend në strehim ju fus
Që të shpëtoni
Dhe lirinë ta gëzoni

e martë • 27 maj 2008

Shqipëri • Kulturë • Art

KOHA Ditore • 27

Organizatorët e këngës evropiane nuk e kanë lejuar politikën në finalen e festivalit

Grupet me bluzat "Kosova është Serbi" largohen nga "Eurosongu"


BEograd, 26 MAJ (KURIR) - Organizatorët e festivalit evropian të këngës „Eurosong“, i cili është mbajtur në Beograd, kanë ndaluar disa të rinj që të mbajnë bluzat në të cilat shkruante „Kosova është Serbi“. Grupi që mbante këto bluzat po e përcillte finalen e festivalit përmes ekranit të madh të vendosur para Kuvendit të Beogradit, ndërsa, sipas gazetës beogradase „Kurir“, organizatorët e festivalit i kishin kërcënuar ata se do ta thërrisnin policinë, po që se bluzat vazhdojnë t'i mbajnë. Skandali, sipas „Kurir“-it, ka marrë një qasje ndërkombëtare ngase bluzat me këtë mbishkrim, krahas vendasve, i kishin të veshura edhe afro 20 të rinj rusë pjesëtarë të organizatës „Nashi“, të cilit kishin ardhur në një vizitë treditore në Serbi. „Kemi qenë të vendosur në të djathtë, fare pranë ekranit ku po transmetohej finalja. Na

janë afruar pjesëtarë të sigurimit duke na thënë se nuk mund të mbajmë veshur bluzat me mbishkrimin „Kosova është Serbi“. Kanë qenë dhjetëra rusë dhe disa tonët që kishin veshur këto bluzat. Ata (sigurimi) na sollën bluzat me mbishkrime laramane në të cilat ishte shkruar „Beograd“ duke i urdhëruar të rinjtë që këto t'i vishnin përmbi bluzat me mbishkrimin „Kosova është Serbi“. Në të kundërt, sigurimi do t'i nxirte jashtë ata që nuk pranonin ta bënin një gjë të tillë, ka thënë për „Kurir“-in, Misho Vaciq, zëdhënës i „Lëvizjes 1389“, e cila ka qenë nikoqire e pjesëtarëve nga organizata ruse „Nashi“. Vaciq, sipas „Kurir“-it, ishte ankuar edhe tek organizatorët e „Eurosong“-ut nga të cilët kishte marrë përgjigje se asnjë bluzë me mesazhe të tilla nuk është e lejuar në këtë organizim.



Poeti Gjekë Marinaj promovon përmbledhjen më të re me poezi

"Lutje në ditën e tetë të javës" sjell Marinajn në Kosovë



PRISHTINË, 26 MAJ - Poeti Gjekë Marinaj, i lindur në Shqipëri por që jeton në SHBA, ka vendosur që poezitë e tij të fundit t'i përmbledhë në një libër, dhe këtë libër ta botojë në Kosovë. Për të ky është një nder i veçantë, pasi Kosova mbetet pjesë e rëndësishme e poezisë së tij. "Kosova është dhe mbetet pjesë e madhe e thelbit të poezisë sime. Shqipëria, Kosova e njerëzimi kanë hyrë në mënyrë natyrale tek poezia ime. Prandaj kur shkruaj poezi nuk filloj me fjalët, por me imazhet, jo me mendimet, por me ndjenjat, jo me imagjinatën, por me observimin. Vetëm më vonë përdor fjalët, mendimet dhe imagjinatën që vargjet të kthehen në poezi", ka thënë Marinaj me këtë rast. Për veprën e Marinajt kanë folur Ramadan Musliu, Prend Buzhala, Mujë Buçpapaj e Ali Jasiqi, ndërsa botuesi Nazmi Rrahmani është shprehur i kënaqur që Marinaj kishte zgjedhur pikërisht shtëpinë botuese "Faik Konica" për të botuar librin e tij.

Sapuni i Titos, së shpejti në treg

ZRENJANIN, 26 MAJ - (Press) Fabrika me qendër në Zrenjanin, "Luksol", planifikon që shumë shpejt në treg të nxjerrë sapunin të cilin dikur e prodhonte ekskluzivisht për Josip Broz Titon. Edhe pse ende nuk është bërë e ditur koha e saktë se kur sapuni i Titos do të mund të blihet, gazeta beogradase "Press" shkruan se ky sapun do të mbajë emrin "Marshall" dhe do të ketë përberësit më cilësorë të mundshëm. Ajo që do ta prodhojë këtë sapun e ka ruajtur kallëpin original me mbishkrimin "English bath soap" përderisa recepti për prodhimin e tij është vazhdon të mbetet "top secret". "Ashtu si tek origjinali, do të përdorim përberësit më cilësorë, si vajra eterike dhe mjaltë", kanë thënë përfaqësuesit e "Luksol", e cila këtë sapun në fillim e kishte prodhuar vetëm për shokun Tito, ndërsa më vonë këtë prodhim kanë mundur ta blejnë edhe krerët më të lartë të shtetit dhe gjeneralët e ish-Armatës Popullore të Jugosllavisë.



A. Sylaj